



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 178, Datë, 04.11.2020

“MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË FTL SHA., PËR DISA  
NDRYSHIME NË “RREGULLOREN PËR PROCEDURAT E BLERJES SË ENERGJISË  
ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETET E SHPËRNDARJES DHE TË  
TRANSMETIMIT DHE PËR BLERJEN DHE SHITJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE PER TË  
SIGURUAR PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE TË SHËRBIMIT PUBLIK”, MIRATUAR ME  
VENDIMIN NR. 103/2016 TË BORDIT TË ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË”.**

Në mbështetje të neneve 16, 19, gërma “l”, 69, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; VKM nr. 244/2016, “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” i ndryshuar, nenit 21, të “Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 103, datë. 23.06.2016, i ndryshuar; nenit 26 të Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, (ERE) në mbledhjen e tij të datës 04.11.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 109/3 datë 12.10.2020 e përgatitur nga Drejtoria e Monitorimit të Tregut, mbi kërkesës së FTL sh.a., për rishikimin e pikës 1/c të nenit 11 të “Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”

**Konstatoi se:**

- Shoqëria FTL sh.a. me shkresën nr. 2773 prot, datë 23.09.2020, ka parashtruar kërkesën për rishikimin e pikës 1/c të nenit 11 të “Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”, miratuar me vendimin nr. 103/2016, të bordit të Entit Rregullator të Energjisë.
- FTL sh.a., bën me dije se, shoqëritë e huaja të regjistruara në platformën IT online të blerjes të energjisë elektrike në mënyrë të vazhdueshme kanë shprehur shqetësimin lidhur me pamundësinë e tyre për

përditësimin në afatin e përcaktuar prej 3 muajsh, të dokumentacionit sipas përcaktimit të pikës 1/c të Nenit 11 të Rregullores, për shkak të afateve të procedurave administrative në shtetet përkatëse dhe të kostove financiare të përditësimit të këtij dokumentacioni.

- Duke patur në konsideratë që disa nga shoqëritë pjesëmarrëse në procedurat e blerjes së energjisë elektrike janë shoqëri të huaja si dhe referuar praktikave më të mira të industrisë dhe precedentëve lokale në lidhje me tregtimin e energjisë elektrike, FTL sh.a., propozon që afati i përditësimit të dokumentacionit sipas pikës 1/c të nenit 11 të Rregullores të bëhet 12 (dymbëdhjetë) muaj.

- Shoqëria FTL sh.a. e bazon kërkesën për ndryshimin e pikës 1/c të nenit 11 të Rregullores së sipërcituar, së pari në eliminimin e kostove financiare të përditësimit të dokumentave çdo tre (3) muaj dhe së dyti referuar praktikave më të mira të industrisë dhe precedentëve lokale në lidhje me tregtimin e energjisë elektrike.

- Bazuar në nenin 19, gërma "1" e Ligjit nr. 43/2015 "Per sektorin e energjise elektrike", i ndryshuar, ERE ka përgjegjësinë për të miratuar, me propozim të të licencuarve rregullat për: i) shitjen, blerjen dhe shkëmbimin e energjisë elektrike, që kryhen nga prodhuesit dhe furnizuesit, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik. Në kuptim të sa më sipër, FTL sh.a. legjitimohet si palë interesi për të kërkuar rishikimin e kësaj Rregulloreje.

- Rregullorja për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik, miratuar me vendimin nr. 103/2016 i ndryshuar, të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë, gjatë shqyrtimit e miratimit të saj ka kaluar në një proces të gjatë konsultimi me palët e interesit si dhe është miratuar me konsultim të ngushtë me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë (ENC-në).

- Në zbatim të rregullave të praktikës së ERE, për këto ndryshime do të njoftohen të gjitha palët e interesit, veçanërisht OST sh.a., si palë direkte e cila gjithashtu zbaton këtë rregullore për procedurat e blerjes së energjisë për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit si dhe Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, për të shprehur opinionet e tyre në lidhje me këto propozime për ndryshim.

- Për shqyrtimin dhe vlerësimin e drejtë të këtij propozimi, do të shërbejnë gjithashtu konsultat që do të kryhen me praktikantët më të mira vendase dhe ndërkomëtare si dhe organet kompetente në Republikën e Shqipërisë.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së FTL sh.a., për një ndryshim në "Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik", miratuar me vendimin nr. 103/2016, të bordit të Entit Rregullator të Energjisë, si më poshtë:

- a. *afati i përditësimit të dokumentacionit të parashikuar në pikën 1, gërma "c" të nenit 11 të Rregullores të bëhet 12 (dymbëdhjetë) muaj*

2. Drejtoria **Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarëveshjeve**, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**